



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Kontrolli i Lartë i Shtetit s'pall procedurat për plotësimin e **1 (një)** vendi vakant, në pozicionin **“Auditues i Dytë” në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit – diplomuar minimumi në Master Profesional në Shkenca Ekonomike.**

I. Kërkesat e përgjithshme

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si më poshtë:

- të jenë shtetas shqiptar;
- të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- ndaj tij/saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit.

II. Kërkesat e veçanta

- **1 (një) vend në pozicionin “Auditues i Dytë” në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit – diplomuar minimumi në Master Profesional në Shkenca Ekonomike.**

Kërkesat për kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune janë:

- Të kenë diplomë minimumi në nivelin Master Profesional;
- Të kenë eksperiencë pune në fushën e diplomimit mbi 3 vite;
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze;
- Të kenë kualifikime dhe trajnime që lidhen me fushën profesionale;
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunuese për të punuar në grup.

Kategoria e pagës për këtë vend pune është III-2.

III. Përshkrimi i punës për pozicionin “Auditues në Departamentet e Auditimit”

Audituesi në Departamentet e Auditimit në KLSH kryen këto detyra kryesore:

- Kryen të gjitha detyrat audituese të ngarkuara bazuar në dispozitat ligjore, standardet profesionale dhe etike brenda afateve të miratuara;
- Zbaton programin e auditimit, për të cilin raporton periodikisht sipas përcaktimeve të rregullores së institucionit;
- Në bashkëpunim me përgjegjës të grupit të auditimit harton programin e auditimit, projekt-raportet, raportet përfundimtare të auditimit;
- Plotëson të gjithë dokumentacionin e auditimit si dhe evidencat statistikore të auditimit të miratuara;
- Harton materialet e auditimit duke dhënë një vlerësim të pavarur, objektiv dhe profesional;
- Në ushtrimin e funksionit auditues zbaton urdhrat e Drejtorit të Departamentit për thellimin e auditimit në çështje të caktuara;
- Në përgatitjen e materialeve të auditimit zbaton Rregulloren e Procedurave të Auditimit, manualët dhe udhëzuesit e auditimit të KLSH-së si dhe mban përgjegjësi për afatet kohore të miratuara;

- Mban përgjegjësi ligjore për çdo lloj shtrembërimi apo falsifikimi të të dhënave të evidentuara dhe të rezultateve të auditimit si dhe për ruajtjen e sekretit shtetëror e tregtar;
- Merr pjesë në të gjitha takimet, ballafaqimet që kryhen me subjektet e audituara ku ka qenë anëtar i grupit të auditimit;
- Jep mendime për përmirësimin e punës së departamentit e të institucionit si dhe për ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore, të cilët ai i çmon të arsyeshme;
- Etj.

IV. Paraqitja e dokumenteve

Kandidatët që shprehin interesin për të aplikuar duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesë ku të jetë specifikuar pozicioni për të cilin aplikojnë;
- Jetëshkrimin e përditësuar me të dhëna të plota në Gjuhën Shqipe;
- Fotokopje të noterizuar të diplomës së nivelit Bachelor dhe Master së bashku me listën e notave;
- Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht sipas legjislacionit në fuqi për njehsimin e diplomave;
- Fotokopje e librezës së punës ose vërtetim për bazën e vlerësuar;
- Fotokopje të letërnjoftimit;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Dokument që vërteton se nuk ka çështje gjyqësore në ngarkim;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Referenca nga punëdhënësi aktual apo të mëparshëm;
- Vërtetim që nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
- Për kandidatët që gëzojnë statusin e Nëpunësit Civil:
 - Vërtetim për kategorinë që mbajnë në shërbimin civil;
 - Vlerësimin e fundit të performancës në punë;
 - Vërtetim që nuk kanë masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokument tjetër që vërteton plotësimin e kriterëve të sipërcituara, si njohuritë e gjuhës së huaj, trajnimeve, kualifikimeve, arsim shtesë si dhe vlerësime pozitive të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentet duhet të jenë aktuale dhe të përditësuara, si dhe të dorëzohen drejtpërsëdrejti në KLSH, brenda datës 15.05.2026.

Mosparaqitja e të gjithë dokumenteve të kërkuara përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

V. Faza e verifikimit paraprak

Në faqen zyrtare të KLSH-së www.klsh.org.al më datë **20.05.2026** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak për kandidatët që plotësojnë kriteret e shpallura të vendit të punës. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email po në të njëjtën ditë. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

VI. Konkurrimi

Kandidatët do të vlerësohen me shkrim mbi njohuritë në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligjin nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së;
- Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së;
- Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së;
- Standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI;

- Manuallet e auditimit që zbaton KLSH;
- Kodin Etik të KLSH-së.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen lidhur me:

- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën lidhur me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Informacionin mbi raportin e Performancës së Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe mbi raportin e Zbatimit të Euxhetit të Shtetit;
- Kuptueshmërinë e rregullave dhe procedurave të punës në KLSH referuar rregulloreve të sipër cituara;
- Kuptueshmërinë teorike të standardeve ndërkombëtare të auditimit INTOSAI, apo manualeve të auditimit të KLSH-së;
- Eksperienat e tyre të mëparshme lidhur me pozicionin e punës;
- Motivimi dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

VII. Fazat dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do t'i nënshtrohen fazave të vlerësimit si, verifikimi paraprak dhe vlerësimi i kandidatëve.

Verifikimi paraprak, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Vlerësimi i kandidatëve, përfshin:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit (arsimimi, përvoja, trajnime të lidhura me fushën);
- b) vlerësimi me shkrim;
- c) intervista e strukturuar me gojë.

Kandidatët duhet të grumbullojnë mbi 50% të pikëve të testit me shkrim me qëllim që të kualifikohen për procesin e vlerësimit të jetëshkrimit. Pas vlerësimit edhe të jetëshkrimit, vetëm kandidatët që kanë grumbulluar mbi 60% të pikëve nga vlerësimi me shkrim dhe vlerësimi i jetëshkrimit së bashku, kualifikohen për intervistën e strukturuar me gojë.

Në përfundim të procesit të vlerësimit vetëm kandidatët që do të grumbullojnë mbi 70% të pikëve totale do të shpallen fitues.

VIII. Njoftimi i kandidatëve

Në faqen zyrtare të KLSH-së, www.klsh.org.al më datë **20.05.2026** do të bëhet shpallja e listës së verifikimit paraprak, data mbi zhvillimin e testimit me shkrim, ndërsa në vijimësi duke respektuar afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor për nëpunësin civil, do të shpallen datat e zhvillimit të intervistës së strukturuar. Kandidatët që nuk do të kualifikohen do të njoftohen me email në çdo fazë të procesit. Njoftimi do të dërgohet për publikim edhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Konkurrimi është i hapur për nëpunës civil dhe për kandidatë jashtë shërbimit civil. Të gjithë kandidatët do t'i nënshtrohen procedurave të konkurrimin të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT